

Numër.....

Podgoricë.....

PROCESVERBAL

nga mbledhja e katërt e rregullt e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve tjerë pakicë dhe bashkësitë tjera të pakicave nacionale

Mbledhja e Komisionit u mbajt më 29.06.2022

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq – kryetar
2. Veron Halili – anëtar
3. Tripo Matijeviq – anëtar
4. Mirheta Gaçeviq – anëtare

Frashër Selimaj anëtar dhe Ivana Krushçiq anëtare nuk morën pjesë në mbledhje për shkak të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë u njoftua kryetari i Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Llekoviq, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

RENDI I DITËS

1. Diskutim dhe deklarim lidhur me Procesverbalin nga mbledhja e tretë e rregullt e Komisionit
2. Analiza dhe komentet në planin programor dhe të produksionit, ndryshimet dhe plotësimet në realizimin e programit në vitin e kaluar,
3. Të ndryshme.

I

Procesverbali nga mbledhja e tretë e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, (4 vota për)

II

Tripo Matijeviq i njoftoi anëtarët tjerë se përbërja e kaluar e Komisionit nuk ka qenë e përfshirë në procesin e sjelljes së planit programor dhe të produksionit dhe se është dashtë që Komisioni t'i drejtohet Këshillit të RTMZ që planet e cekura të sigurohen në fazën e propozimit, në mënyrë që të jepen vërejtjen e caktuara të cilat do të kontribuonin në përmirësimin e kualitetit të tyre. Për sa i përket planit programor dhe të produksionit të TVMZ për vitin 2022, ai konsideron se ka ardhur deri të përmirësimin e tij në krahasim me atë të kaluarin në aspektin se është shtuar përqindja e emisioneve të planifikuara prej 2.6 %, në 4.2 % edhe pse ai mendon se kjo nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu propozoi që do të duhej të shihet raporti për realizimin e planeve nëse ka ardhur deri të shtimi i vërtet ose ishte planifikuar e nuk është realizuar.

Për sa i përket RMZ, ai konsideron se përqindja e emisioneve të planifikuara prej 5 % është standard, respektivisht përsëritet tash një kohë të gjatë dhe paraqet një situatë më të mirë krahasuar me TVMZ. Ai theksoi se sipas mendimit të tij, përfshirja do të ishte më e mirë me emisionet të cilat nuk realizohen më, për sa i përket shqyrtimit të kulturës dhe trashëgimisë të popujve pakicë.

Admir Adroviq tërhoqi vërejtjen lidhur me Redaksinë e programit në gjuhët e pjesëtarëve të popujve tjerë pakicë dhe bashkësive tjera të pakicave nacionale, konkretisht në serialin “Mostovi”, i cili ishte planifikuar të realizohet në 44 emisione nga 30 minuta si dhe “Savore” kushtuar popullatës rome në 22 emisione, me nga 25 minuta. Ai konsideron se intervali kohor i paraparë për emetimin e emisionit “Mostovi” nuk është i mjaftueshëm, edhe pse është përmirësuar, duke pasur parasysh se duhet të përfshihen të gjitha bashkësitë e pakicave, përveç asaj rome. Ai gjithashtu konsideron se është shqetësuese se programi informativ i TVMZ merr 56 % të programit, ndërsa për emisionet arsimore janë vetëm 3% të programit. Tripo Matijeviq tha se emisioni “Mostovi” dikur është emetuar edhe deri në 60 minuta e pastaj në 45, kurse tani në vetëm 30 minuta. Në intervalin e cekur emetohen 12 deri në 15 minuta material, derisa pjesën tjetër e merr sigla e emisionit dhe reklamat që për të është e papranueshme. Për sa i përket kualitetit të emisionit të cekur ai konsideron se është i kënaqshëm por pret të shtohet koha e emetimit dhe se programi të plotësohet me emisione të reja, për shembull në favor të programit informativ. Mirheta Gaçeviq po ashtu konsideron se duhet shtuar numri i emisioneve për popujt pakicë në favor të programit informativ. Krahas kësaj konsideron se duhet përfshirë Fondet për pakica dhe Këshillat e pakicave lidhur me temat të cilat do të trajtohen në emisione, për arsye se atje gjenden projektet kualitative të cilat do të kontribuonin në kualitetin e emisioneve dhe do të lehtësonin punën në përgatitjen tyre. Tripo Matijeviq thotë se në periudhën e kaluar ka ekzistuar bashkëpunimi me Këshillin Nacional Kroat, konkretisht Radio e Malit të Zi ka pasur bashkëpunim me Radio “Duks” dhe se do të kishte hapësirë për avancimin e bashkëpunimit. Tripo Matijeviq theksoi se programi zbavitës komercial merr 6% të programit, programi për pakica 4.2%, kurse programi edukativo-arsimor 3.6%, që sipas tij po ashtu është e papranueshme.

III

Në kuadër të pikës së tretë, “Të ndryshme”, nuk kishte tema për diskutim.

PROCESVERBALIN E MBAJTI
IVAN LEKOVIQ

KRYETARI I KOMISIONIT
ADMIR ADROVIQ